



## Master i Shkencave i Ri në “Financë dhe Kontabilitet”

me dy profile: Financë-Bankë • Kontabilitet-Auditim

“Pas çdo vendimmarrjeje të zgjuar, qëndrojnë njohuritë financiare”

### Program për nivelin Master i Shkencave në "Financë dhe Kontabilitet"

Programi i Masterit Shkencor në Financë dhe Kontabilitet përfaqëson një ofertë akademike të avancuar, e konceptuar për të siguruar një formim të thelluar teorik dhe profesional në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë dhe kërkesat e tregut të punës. Programi është i strukturuar në dy profile të mirëpërcaktuara—Financë-Bankë dhe Kontabilitet-Auditim—duke u mundësuar studentëve specializim të diferencuar dhe zhvillim të kompetencave të avancuara në fushat përkatëse.

I orientuar ngushtësisht me zhvillimet strukturore të ekonomisë shqiptare, programi kontribuon në përgatitjen e specialistëve të kualifikuar për të përballuar sfidat që lidhen me forcimin e kuadrit rregullator, përmirësimin e praktikave financiare dhe kontabël, si dhe avancimin e procesit të integritimit evropian. Në këtë kuadër, ai integron në mënyrë të balancuar formimin teorik të avancuar me qasje praktike bashkëkohore, përmes përdorimit të softuerëve të specializuar, aplikimit të teknikave moderne të analizës dhe vendimmarrjes financiare, si dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar.

Një komponent thelbësor i programit është dimensionin kërkimor, i cili materializohet në përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës së Masterit, duke synuar zhvillimin e aftësive analitike, kritike dhe metodologjike të studentëve në trajtimin e çështjeve komplekse financiare dhe kontabël. Gjithashtu, programi bazohet në parimin e ndërdisiplinaritetit, duke integruar njohuri nga ekonomia, shkencat sociale, shkencat e natyrës dhe teknologjia, në përputhje me qasjet moderne të reformimit të arsimit të lartë dhe modelet bashkëkohore ndërkombëtare.

Në tërësi, Programi i Masterit Shkencor në Financë dhe Kontabilitet synon të formojë profesionistë dhe kërkues të nivelit të lartë, të pajisur me kompetenca të avancuara analitike dhe praktike, të aftë për të kontribuar në mënyrë efektive në zhvillimin dhe modernizimin e sektorit financiar dhe kontabël, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

### Qëllimet kryesore të programit

Objektivat kryesore të programit të studimeve *Master Shkencor* në “Financë dhe Kontabilitet” janë:

- **Të ofrojë një formim të avancuar teorik dhe praktik** në fushat e financës dhe kontabilitetit, në përputhje me standardet bashkëkohore akademike dhe profesionale.
- **Të zhvillojë kompetenca të specializuara** në profilet Financë-Bankë dhe Kontabilitet-Auditim, duke mundësuar përgatitjen e studentëve për role të avancuara profesionale.
- **Të pajisë studentët me aftësi analitike dhe vendimmarrëse**, përmes aplikimit të teknikave moderne të analizës financiare, përdorimit të softuerëve të specializuar dhe interpretimit të të dhënave komplekse.
- **Të sigurojë njohuri të thelluara mbi standardet ndërkombëtare** të raportimit financiar, auditimit dhe rregullimit financiar, në funksion të integritetit në tregjet ndërkombëtare.
- **Të zhvillojë kapacitete kërkimore dhe metodologjike**, duke mundësuar analizën kritike dhe trajtimin shkencor të çështjeve në financë dhe kontabilitet, të materializuara përmes tezës së Masterit.
- **Të nxisë qasjen ndërdisiplinare**, duke integruar njohuri nga ekonomia, shkencat sociale dhe teknologjia në analizën dhe zgjidhjen e problemeve komplekse.
- **Të përgatisë profesionistë të aftë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik**, përmes përmirësimit të praktikave financiare, forcimit të kuadrit rregullator dhe mbështetjes së proceseve të integritetit evropian.

## Kompetencat kryesore të fituara

Studentët e diplomuar në këtë program do të fitojnë:

- Njohuri të thelluara profesionale dhe aftësi analitike në financë dhe kontabilitet, të zbatueshme në sektorin privat, publik dhe në sektorin bujqësor e agrobiznesit.
- Aftësi për të vlerësuar dhe adresuar riskun financiar dhe për të përdorur qasje bashkëkohore në analizën e shëndetit financiar të njësisve ekonomike.
- Kompetenca në raportim financiar ndërkombëtar, auditim, kontabilitet të avancuar financiar dhe zbatim të standardeve të kontabilitetit për sektorin privat dhe publik.
- Kapacitete për planifikim financiar, buxhetim, vlerësim ndërmarrjesh dhe vlerësim financiar të projekteve të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Kompetenca specifike në financat rurale: financimin e bujqësisë, agrobiznesit, agroturizmit dhe zhvillimit rural.
- Aftësi për të hartuar dhe vlerësuar politika ekonomike e projekte që nxisin zhvillimin dhe përafrimin me politikat e Bashkimit Evropian.

## Mundësi punësimi

Të diplomuarit mund të ndjekin karrierën në pozicionet e rolet e mëposhtme si:

- **Institucione financiare bankare dhe jobankare** — banka të nivelit të dytë, institucione të mikrofinancës dhe mikrokredisë, kompani sigurimesh; në role të analizës financiare, kontabilitetit, auditimit dhe raportimit.

- **Institucione publike në nivel qendror**, përfshirë ministritë, si dhe agjencitë dhe entet publike me funksione në fushat e financës, auditimit dhe raportimit.
- **Qeverisje vendore**— 61 bashki, në pozicione të planifikimit buxhetor, raportimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.
- **Ndërmarrje private** — ndërtim, shërbime, agrobiznes dhe agroturizëm; në role të financës, kontabilitetit, kontrollit të kostove dhe drejtimit.
- **Në institucionet e arsimit të lartë dhe në institucionet e kërkimit shkencor**, publike dhe private, në pozicione të tilla si specialist i financave dhe buxhetit, analist investimesh dhe asistent kërkimor.
- **Në institucione dhe organizata ndërkombëtare**, në pozicione profesionale në fushën e financës dhe kontabilitetit, si dhe në vlerësimin dhe monitorimin e projekteve dhe politikave zhvillimore.
- **Kualifikime ndërkombëtare** — programi përgatit studentët edhe për certifikime si ACCA, CPA dhe CIA, duke zgjeruar mundësitë e punësimit në tregjet ndërkombëtare.

## Struktura e programit

Programi i Masterit Shkencor në Financë dhe Kontabilitet zhvillohet përgjatë dy viteve akademike (katër semestra), duke siguruar një progresion të strukturuar nga formimi teorik i avancuar drejt specializimit profesional dhe kërkimit shkencor. Në tërësi, programi siguron një balancë të qëndrueshme ndërmjet formimit teorik, aplikimit praktik dhe kërkimit shkencor, duke përgatitur të diplomuar të kualifikuar për karrierë në sektorin financiar, institucionet publike dhe private, si dhe në fushën akademike dhe kërkimore.

Në **vitin e parë**, programi fokusohet në ndërtimin e një baze të konsoliduar teorike dhe metodologjike. Në semestrin e parë, studentët thellojnë njohuritë në mikroekonomi dhe makroekonomi të avancuar, metodologjinë e kërkimit dhe modelimin financiar, si dhe zhvillojnë kompetenca në ekonometrinë dhe drejtimin e riskut financiar. Gjithashtu, trajtohen aspektet thelbësore të raportimit financiar në përputhje me standardet bashkëkohore. Në semestrin e dytë, programi zgjerohet drejt dimensioneve ndërkombëtare dhe aplikative, përmes moduleve si financa ndërkombëtare, drejtimi financiar i avancuar, kontabiliteti financiar i avancuar dhe sistemet e informacionit kontabël. Po ashtu, përfshihen fusha specifike si vlerësimi i aktiveve bujqësore dhe analiza e kostove mjedisore për zhvillim të qëndrueshëm.

Në **vitin e dytë**, programi orientohet drejt specializimit të thelluar dhe integritit të njohurive në kontekste profesionale dhe kërkimore, duke reflektuar njëkohësisht një qasje ndërdisiplinore. Në semestrin e tretë, studentët ndjekin module të avancuara si drejtimi i institucioneve financiare, financa e gjelbër, legjislacioni dhe admistrim fiskal dhe drejtimi i portofolit. Një komponent i rëndësishëm i këtij semestri është fleksibiliteti përmes lëndëve me zgjedhje, të cilat mundësojnë profilizim të mëtejshëm në fusha si operacionet e sigurimeve dhe menaxhimi i rreziqeve klimatike, auditimi dhe kontrolli i brendshëm, rregullimi dhe mbikëqyrja financiare, financa personale, si dhe tematika të lidhura me bujqësinë digjitale dhe mjedisin. Ky kombinim reflekton ndërthurjen e financës dhe kontabilitetit me dimensione të teknologjisë, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Në varësi të profilit të zgjedhur (Financë-Bankë ose Kontabilitet-Auditim), studentët ndjekin module të specializuara përkatëse që thellojnë kompetencat profesionale.

Në **semestrin e katërt**, programi përqendrohet plotësisht në komponentin kërkimor. Studentët ndjekin seminarin për orientimin e tezës, i cili i udhëzon në përzgjedhjen e temës dhe strukturimin metodologjik të punimit shkencor, dhe më pas angazhohen në përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës së Masterit. Ky proces synon të konsolidojë aftësitë kërkimore, analitike dhe kritike, duke i mundësuar studentëve të trajtojnë në mënyrë të pavarur çështje komplekse në fushën e financës dhe kontabilitetit.

## Qasja ndërdisiplinore

Në ndërtimin e programit është ndjekur parimi i ndërdisiplinaritetit — integrimi i qasjeve, metodave dhe mjeteve analitike nga disiplina të ndryshme për të prodhuar njohuri dhe zgjidhje të zbatueshme për sfida komplekse ekonomike, financiare, sociale dhe teknologjike. Ky parim pasqyron natyrën e ndërlidhur të mjedisit bashkëkohor dhe u mundëson studentëve të zhvillojnë një perspektivë të gjerë dhe të integruar në analizën dhe zgjidhjen e problemeve. Në këtë kuadër, programi ndërthur elemente nga ekonomia, financa, kontabiliteti dhe teknologjia, duke nxitur mendimin kritik, analizën e avancuar dhe aftësinë për vendimmarrje të informuar në kontekste dinamike dhe komplekse.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare (Muster Curricula), programi bazohet në një qasje ndërdisiplinore, duke integruar njohuri nga teknologjia, shkencat natyrore dhe ekonomia, me qëllim ofrimin e një formimi të plotë dhe të balancuar për përballimin e sfidave komplekse. Struktura e krediteve reflekton këtë qasje, ku shkencat sociale përbëjnë rreth 60% të totalit, ndërsa shkencat natyrore dhe ato teknike zënë përkatësisht rreth 20% secila.